

# **Development and Implementation of MDTV Curricula (DIMTV)**

## **WP2.4 - Activity 2.4.2**

**Të dhëna mbi regjistrimin e studentëve në masterin e MTVD në  
UAMD dhe programet e tjera të studimit në UP, EPOKA dhe UBT**

Project Duration: Oct 2017 – Oct 2020 (Extended to October 2021)

Start Date of Deliverable: September 2018

Submission Date: September 2021

Dissemination level: Department/Faculty, Regional, International

Lead Organization: UAMD

## PROGRAMI I STUDIMIT MASTER PROFESIONAL MULTIMEDIA DHE TELEVISION DIXHITAL - UAMD

Studentët që kanë përfunduar studimet bachelor në fusha të lidhura me multimedian mund të aplikojnë për të qenë pjesë e studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në MDTV. Në faqen zyrtare të UAMD-së dhe rrjeteve sociale, publikohet lajmi për aplikime në fillim të procedurave të regjistrimit.

Në përfundim të procesit të aplikimit, Përgjegjësi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit vendos anëtarët e komisionit ad-hoc i cili do të vlerësojë studentët aplikantë. Ky komision shqyrton të gjithë dokumentacionin përkatës dhe bën një tabelë vlerësimi në bazë të pikëve. Studentët fitues renditen dhe shpallen publikisht. Në momentin e shpalljes studentët fituese i nënshtrohen procesit të regjistrimit.

Programi i studimit master profesional është implementuar në kuadër të projektit DIMTV dhe duke filluar nga viti akademik 2018-2019 ka qenë aktiv duke pranuar studentë. Në vitin e parë të implementimit u regjistruan 17 studentë, të cilët ndoqën masterin gjatë vitit akademik 2018-2019 dhe u profilizuan në modulën Produksion dhe Post-Produksion. Arsyeja përse u hap ky modul dhe jo të tjerët përputhej me dëshirën e studentëve që zgjedhën këtë profil dhe bazuar në legjislacionin përkatës për organizmin e studimeve me këtë numër të vogël studentësh është e vështirë të hapen të treja modulet.

Shumica e studentëve që u regjistruan në master kishin mbaruar studimet bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital. Kishte dhe raste studentësh që kishin mbaruar studimet në Universitetin e Politeknikut por që kishin mbaruar studimet e nivelit të parë në mekatronikë dhe fusha jashtë multimedias. Këta studentë e kishin fokusuar aktivitetin e tyre profesional në fushën e multimedias dhe për të siguruar vazhdimësinë në vendin e punës dhe për të dokumentuar njohuritë e tyre e panë masterin profesional si një zgjidhje efikase të këtyre problematikave.

Viti i dytë dhe viti i tretë akademik, 2019-2020 dhe 2020-2021, u realizuan në një periudhë të vështirë ndikuar nga pandemia. Përtej kësaj numri i studentëve të regjistruar ishte 15 dhe 13 respektivisht. Shumica e studentëve vinin nga studimet e nivelit të parë në Bachelor Multimedia dhe Televizion Dixhital. Kjo shpjegon dhe numrin e vogël të studentëve të masterit pasi fusha është shumë e specializuar dhe tërheq grupe të orientuara tek Multimedia. Në vitin e dytë të implementimit të masterit studentët, njësoj si në vitin e parë, u profilizuan në Produksion dhe Post-produksion, kjo gjithëmonë bazuar në preferencat e studentëve. Ndërsa në vitin e tretë të realizimit studentët u profilizuan në modulën Animim

3D, po sipas preferncës së studentëve. Në vitin 2021-2022 15 studentë u regjistruan gjatë kësaj periudhe.

Ajo çfarë është vënë re në të katërta vitet është niveli i lartë i cilësisë së studentëve dhe serioziteti apo përgjegjshmëria e studentëve duke i përfunduar të gjitha detyrimet e studimeve brenda afatit kohor të përcaktuar.

Përsa i përket punësimit të studentëve, nga raportet e brendshme dhe të dhënat që janë mbledhur në kuadër të projektit mund të themi se rreth 53 % e studentëve të diplomuar tek Masteri janë punësuar në tregun e punës në fushën e tyre të studimit.

## PROGRAMI I STUDIMIT - UP

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” është zgjedhja e parë për studentët kosovarë. UP-ja është institucion publik, më prestigjiozi i arsimit të lartë dhe më i madhi në hapësirën shqipfolese. Për shkak të historikut të tij pesë dekadësh, universiteti ynë njihet si një zgjedhje e sigurt dhe e qendrueshme për studime, i cili ofron një listë të gjerë të programeve akademike. UP-ja shtrihet në qendrën e kryeqytetit, në kampusin më të gjerë në Kosovë, duke shërbyer edhe si qendër e aktiviteteve akademike e profesionale në vend, me profesorët më eminentë të fushave.

Studimet master zgjasin 1 respektivisht 2 vjet dhe kërkojnë 60 respektivisht 120 pikë të ECTS-së. Përfundimi me sukses i studimeve themelore – bachelor është kusht për regjistrimin e studimeve master. Gjatë projektit DIMTV janë përditësuar kurse të ndryshme në programe aktuale të akredituara dhe janë implementuar që nga viti akademik 2018-2019 diku ku kanë marrë pjesë më shumë se 50 studentë. Për më shumë detaje, për numrin e mëposhtëm të studentëve që janë regjistruar ndër vite në kurset e përditësuara gjendet si mëposhtë:

Më shumë se 20 studentë për semestër për vitin akademik 2018-2019, më shumë se 20 studentë për vitin akademik 2019-2020 dhe më shumë se 20 studentë për vitin akademik 2020-2021. Ndërkohë që duke filluar në vitin e ri akademik 2021, 30 studentë master priten të ndjekin studimet në programin e ri master që përfundon në Shtator të 2023.

## PROGRAMI I STUDIMIT – EPOKA

Studentët që regjistrohen tek epoka duhet të ndjekin procedurën e prezantuar në figurën 1 në lidhje me regjistrimin e studentëve në këtë universitet.

Studentët të cilët kanë aplikuar dhe i përmbushin kushtet duhet të paraqesin në zyrën përkatëse dokumentat e kërkuara. Në varësi të programit të studimit duhet të kryhen detyrimet financiare përkatëse përpara fillimit të vitit akademik nga ana e studentit dhe më pas të nënshkruhet marrëveshje përkatëse midis zyrës së regjistrimit dhe studentit. Në përfundim të kësaj faze dhe mbas dakortësisë së palëve do të kryhet pajisja e studentit me dokumentacionin përkatëse studentor i cili do ti shërbejë gjatë kohës që është aktiv në një nga programet e studimit.

Studentët e regjistruar në programin Master të përditësuar me kurse multimediale gjatë vitit akademik 2019-2020, 13 studentë janë regjistruar në Shkenca Kompjuterike dhe 4 studentë në programin e studimit Inxhinieri elektronike dhe komunikimi, ndërsa për vitin akademik 2020-2021 janë 14 studentë për programin Shkenca Kompjuterike dhe 11 studentë për Inxhinieri elektronike dhe komunikimi.




Figure 1: Procedura e regjistrimit tek EPOKA

## PROGRAMI I STUDIMIT - UBT

Sistemi europian i bazuar në marrëveshjen e Bolonjës dikton përmbajtjen kryesore të studimit master në UBT. Pritshmëria është që ky sistem të ofrojë një gamë më të gjerë zgjedhjesh si dhe të intensivikojë procesin e studimit për studentët. Kurrikula u ofron studentëve njohuri brenda specialitetit të tyre si dhe kompetenca sociale, zhvillon gatishmërinë e tyre për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe krijon mundësi për tranzicione dhe kërkime ndërkurrikulare.

Ngarkesa e studentëve matet duke përdorur ECTS. Në ECTS, 60 kredite përfaqësojnë ngarkesën e punës për një vit të plotë studimi. Për të marrë një diplomë Master në Kolegj, studentëve u kërkohet të arrijnë një minimum prej 120 kreditesh gjatë dy viteve të studimit. Kohëzgjatja e një studimi master është përgjithësisht dy vite akademike me disa përjashtime të përcaktuara nga rregulloret kombëtare në fushën e Drejtësisë (një vit) dhe programet e integruara në Farmaci dhe Stomatologji (pesë vjet).

Gjatë projektit të DIMTV kurrikulat janë përditësuar me kurse të dedikuara në fushën e multimedias dhe një numër i madhë studentësh kanë përfituar nga këto kurse. Informacioni paraqitet si mëposhtë:

Numri i përgjithshëm i studentëve që përfituan nga kurset e reja dhe të përditësuara të lidhura me multimedian në abachelor dhe master në Shkenca Kompjuterike dhe Inxhinieri, Media dhe Komunikim, Art dhe Media Digjitale dhe Menaxhim Mekatronikë është 1084 për vitin akademik 2018-2019, 1057 për vitin akademik 2019-2020 dhe 256 për vitin akademik 2020-2021.